



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

---

## **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit**

Programi i studimit:

**Programi: Edukimi në Fëmijërinë e Hershme**

*Niveli i studimeve:*

Bachelor

*Numri i kredive:*

240 ECTS

*Akredituar për periudhën:*

1 Tetor 2021 - 30 Shtator 2024

## PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	3
2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT .....	4
3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Edukimi në Fëmijërinë e Hershme .....	5
4. PËRSHKRIMET E KURSEVE .....	8

## 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi kryesor i programit është përgatitja e edukatorëve të ardhshëm të cilët do të jenë kompetentë në punën profesionale me fëmijët parashkollorë. Ky program synon që edukatorët e ardhshëm të zotërojnë anën teorike të fushës së tyre profesionale, të zbatojnë teorinë në praktikën e përditshme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese dhe të zhvillojnë aftësi praktike për të ndihmuar fëmijën në zhvillimin e tyre fizik, social, emocional dhe njohës. Kompetencat e edukatorëve të ardhshëm synojnë të arrihen përmes programit katërvjeçar, i cili përfshin aspekte nga fusha e psikologjisë dhe pedagogjisë së fëmijërisë së hershme, pedagogjisë lëndore/ akademike dhe praktikës pedagogjike të organizuara në kopshte dhe shkolla brenda të cilave ato janë të vendosura klasat parafillore. Gjatë periudhës katër vjeçare studentët do të përfshihen gjithashtu në aktivitete të ndryshme jashtëshkollore, si dhe kërkime të ndryshme që do t'i ndihmojnë ata të identifikojnë dhe zgjidhin çështje që lidhen drejtpërdrejt me punën e tyre me fëmijët e moshës 0-6 vjeç.

Misioni i programit BA Edukimi në Fëmijëri të Hershme është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit. Misioni i programit është të sigurojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të edukatorëve, të cilët do të jenë kompetentë në punën profesionale me fëmijët parashkollorë.

## 2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

- Zhvillojnë njohuri për qasjet teorike për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve nga lindja deri në moshën 6 vjeç;
- Zbatojnë në praktikë qasje teorike gjatë aktiviteteve edukative sipas grupmoshave të caktuara (lindje -6 vjeç);
- Zbërthenjnë kurrikulën në aktivitete të planifikuara për fëmijët sipas grup-moshës, duke e orientuar punën e tyre sipas qasjeve bashkëkohore me fëmijën në qendër;
- Zbatojnë metodologji bashkëkohore gjatë punës me fëmijë, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi fizike, gjuhësore, koncepte matematikore e shkencore e artistike dhe të përgatiten për jetë, punës dhe mjedis;
- Përdorin teknologjinë për të kryer aktivitete edukative dhe e integrojnë atë në edukim;
- Përdorni forma të ndryshme të vëzhgimit të fëmijës për të identifikuar nevojat, interesat e tyre individuale dhe për të vlerësuar arritjet zhvillimore dhe njohëse të fëmijës;
- Sigurojnë mundësi për qasje gjithëpërfshirëse në procesin e zbatimit të planit dhe programit, duke i dhënë mundësi të barabarta secilit;
- Përgatisin mjedisin për të siguruar ndërveprime midis fëmijëve, ndërveprime midis fëmijëve dhe të rriturve dhe për të krijuar mundësi për integrim të natyrshëm ndërfaqësor.
- Promovojnë komunikimin kopsht-familje-komunitet dhe aplikojnë qasje të ndryshme për partneritetin me familjen dhe komunitetin;
- Reflektojnë dhe planifikojnë zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës me fëmijë.
- Promovojnë vlerat, besimet, qëndrimet mbi të cilat zhvillohet identiteti shoqëror dhe kombëtar bazuar në vlerat demokratike për arsimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vend.

### 3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Edukimi në Fëmijërinë e Hershme

VITI I					
SEMESTRI I					
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	TEORI E EDUKIMIT	3	1	6
2.	O	HYRJE NË PSIKOLOGJI	3	1	6
3.	O	GJUHË SHQIPE I	3	1	6
4.	O	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (LINDJE -3 VJEÇ)	3	1	6
5.	O	TIK-u PËR EDUKATORE	3	1	6
			15	5	30
1	O	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (3 -6 VJEÇ)	3	1	6
2	O	GJUHË SHQIPE II	3	1	6
3	O	ARTI FIGURATIV PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	1	5
4	O	EDUKIM FIZIK PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	1	5
5	Z	SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE	2	0	4
6	Z	TË NXËNIT PËRMES LOJËS	2	0	4
7	Z	USHQYESHMËRIA PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
8	Z	KULTURË SHKRIMI	2	0	4
			14	4	30
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	PSIKOLOGJIA E ZHVILLIMIT PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	2	6
2.	O	KONCEPTET MATEMATIKORE NË FËMIJËRINË E HERSHME	3	1	6
3.	O	MUZIKA PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	1	5
4.	O	GJITHËPËRFSHIRJA NË FËMIJËRI TË HERSHME	3	0	5
5.	Z	LOJËRAT SKENIKE	2	0	4
6.	Z	IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMET E HERSHME	2	0	4
7.	Z	PARTNERITETI ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN	2	0	4
8.	Z	ZHVILLIMI GJUHËSOR	2	0	4
9.	Z	INTERPRETIMI I TEKSTIT LETRAR	2	0	4

			14	4	30
1	O	KONCEPTET GJEOMETRIKE NË FËMIJËRINË E HERSHME	3	1	6
2	O	GJUHË ANGLEZE	3	1	6
3	O	INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE	2	1	5
4	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II (LINDJE -3 VJEÇ) (5 JAVË)	3	0	5
5	Z	SHKATHTËSITË E INTEGRUARA GJUHËSORE	2	0	4
6	Z	QASJET E EDUKIMIT ME FËMIJËN NË QENDËR	2	0	4
7	Z	HISTORI KOMBËTARE PËR FËMIJË	2	0	4
8	Z	ZHVILLIMI PSIKO-MOTORIK	2	0	4
			15	3	30
<b>Nr.</b>	<b>O/Z</b>	<b>Lëndët</b>	<b>L</b>	<b>U</b>	<b>ECTS</b>
1.	O	SHKENCAT E NATYRËS NË FËMIJËRI TË HERSHME	3	1	6
2.	O	PSIKOLOGJI E EDUKIMIT	3	1	6
3.	O	ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I KURRIKULËS	2	1	5
4.	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III (3 -6 VJEÇ) (6 JAVË)	3	0	5
5.	Z	PSIKOLOGJIA E PERSONALITËTIT	2	0	4
6.	Z	LETËRSI POPULLORE	2	0	4
7.	Z	KREATIVITËTI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
8.	Z	MBROJTJA DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE	2	0	4
9.	Z	LOJËRAT MATEMATIKORE PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
			15	3	30
1	O	SHOQËRIA DHE MJEDISI	3	1	6
2	O	VLERËSIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	3	1	6
3	O	EDUKIMI SHËNDETËSOR	2	1	5
4	O	LETËRSI PËR FËMIJË	3	0	5
5	Z	METODOLOGJIA MONTESORIANE	2	0	4
6	Z	ZHVILLIMI SOCIO-EMOCIONAL	2	0	4
7	Z	EDUKIMI PËRMES STEM	2	0	4
8	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM	2	0	4
			15	3	30
<b>Nr.</b>	<b>O/Z</b>	<b>Lëndët</b>	<b>L</b>	<b>U</b>	<b>ECTS</b>
1.	O	STANDARDET DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE	2	2	6
2.	O	EDUKIMI PËRMES DRAMATIZIMIT DHE SHFAQJET ME KUKULLA	3	1	6

3.	<b>O</b>	ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËR JETË	2	1	5
4.	<b>O</b>	MJEDISI I TË NXËNIT	3	0	5
5.	<b>Z</b>	LOJËRAT NË NATYRË	2	0	4
6.	<b>Z</b>	METODOLOGJIA REXHIO EMILIA	2	0	4
7.	<b>Z</b>	LOJËRAT MUZIKORE	2	0	4
8.	<b>Z</b>	EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI	2	0	4
			14	4	30
1	<b>O</b>	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2	2	6
2	<b>O</b>	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV (8 javë)	3	0	14
3	<b>O</b>	PROVIMI PËRFUNDIMTAR/PUNIMI I DIPLOMËS			10
			5	2	30

## 4. PËRSHKRIMET E KURSEVE

### Përshkrimi për secilin kurs

#### **TEORI E EDUKIMIT**

Kursi fokusohet në teoritë themelore të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe ju ndihmon studentëve të njihen me parimet dhe filozofinë e edukimit. Gjatë këtij kursi studentët do të njihen me qasjet e ndryshme teorike të edukimit të fëmijëve, gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë. Përgjatë diskutimeve dhe reflektimeve studentët do të kenë mundësi të fokusohen në analizat e pikëpamjeve të shumëfishta të teorive të edukimi dhe gradualisht të ndërtojnë filozofinë e tyre përkitazi me teoritë e edukimit dhe aplikimit praktik të tyre

#### **HYRJE NË PSIKOLOGJI**

Kursi është i dizajnuar në mënyrë që të njoftojë studentët me konceptet dhe teoritë kryesore që e përkufizojnë psikologjinë si shkencë të studimit të mendjes dhe sjelljes, dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme. Kursi shtjellon teoritë themelore psikologjike dhe metodat e studimit të saj, njohuritë e proceseve bazike kognitive, emocionale dhe bihejviorale sipas gjurmimeve empirike, dhe analizën e llojllojshmërisë së faktorëve që ndikojnë ndijimet, perceptimet, të mësuarit, kujtesën, motivimin, ndjenjat dhe shëndetin. Kursi bën diferencimet në mes të informatave shkencore dhe jo-shkencore rreth sjelljes njerëzore dhe proceseve mendore, dhe përshkruan proceset psikologjike që ndërveprojnë tek fëmija. Njohuritë nga kursi u ofrojnë studentëve një perspektivë të plotë mbi botën, njohjen e vetes dhe të tjerëve dhe të kuptuarit e kompleksitetit të sjelljes njerëzore, dhe do të fokusohet në ngritjen e shkathësive të studentëve për të zbatuar konceptet dhe parimet psikologjike në situata të punës dhe jetës së përditshme.

#### **GJUHË SHQIPE I**

Përmes këtij kursi studentët do t'i zgjerojnë njohuritë e tyre paraprake përkitazi me: prejardhjen e gjuhës shqipe, dokumentimin e saj, dialektet dhe rrugën e zhvillimit të saj. Ata do të njihen teorikisht dhe praktikisht edhe me elementet themelore të sistemit fonetiko-fonologjik dhe të normës gjuhësore: drejtshqiptimin, dallimin e tingujve nga morfemat, klasifikimin e tingujve, nyjëtimin e tyre; për theksin, dukuritë fonetike etj. Po ashtu do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në pjesën e morfologjisë: sistemi fjalëformues i gjuhës, si dhe për pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emri, mbiemri, numërori, përemri me kategoritë e tyre morfologjike.

#### **EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (lindje -3 vjeç)**

Kursi “Edukimi në fëmijërinë e hershme me praktikë (lindje – 3 vjeç)” përmban njohuritë themelore në fushën e edukimit të fëmijëve nga viti i parë i lindjes deri në moshën 3 vjeç. Duke filluar me sqarimin e nocioneve themelore dhe terminologjisë profesionale shkencore e cila do të shoqërojë studentët përgjatë gjithë studimeve e të tutje. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë specifikat mbi edukimin e institucionalizuar, stukturimin, ndarjen e grupeve edukative, rolin e edukatores duke i respektuar individualitetin e fëmijëve dhe

kërkesat që dalin nga fëmijët e kësaj grup-moshe. Lënda synon që studentët të përvetësojnë njohuri dhe shkathtësi për të ofruar veprimtari edukative në mënyrë që edukimi i institucionalizuar të jetë në funksion të mirërritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijës. Do të trajtohet poashtu dokumentacioni zyrtar dhe ai pedagogjik i cili përdoret për fëmijët përgjatë edukimit të institucionalizuar. Praktika e cila do të organizohet në kuadër të kësaj lënde, e cila do të mbahet në IP, do të ndihmojë studentët të observojnë dhe refletojnë atë që kanë përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit mbi edukimin e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç

### **TIK-u PËR EDUKATORE**

Kursi synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuri lidhur me konceptet e TIK-ut dhe llojet kryesore të Teknologjive të Edukimit për komunikim dhe punë me fëmijë. Kursi shtjellon nocionet e ndërveprimit të fëmijës me TIK-un në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të tij. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar: Lodrat e programueshme, TIK Lodrat (ICT toys), Teknologjitë e Edukimit dhe Teknologjitë e Internetit në aktivitete me fëmijë. Studentët mësojnë se si t'i përdorin këto lojëra dhe teknologji në kontekstin "shkak – efekt", për të ndihmuar zhvillimin e kreativitetit dhe të të menduarit kritikë të fëmijëve, t'i ndihmojnë fëmijët që të kuptojnë se si punojnë paisjet themelore të TIK-ut dhe si mund të përdoren gjatë jetës së tyre të përditshme.

### **EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (3 -6 vjeç)**

Kursi "Edukimi në fëmijërinë e hershme me praktikë (3 – 6 vjeç)" është vazhdimësi e kursit "Edukimi në fëmijërinë e hershme me praktikë (3-6 vjeç) dhe trajton çështjet të cilat kanë në fokus edukimin e e institucionalizuar për fëmijët nga mosha 3-6 vjeç. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë specifikat mbi edukimin e institucionalizuar, strukturimin, ndarjen e grupeve edukative, rolin e edukatores duke i respektuar individualitetin e fëmijëve dhe kërkesat që dalin nga fëmijët e kësaj grup-moshe. Atyre do t'ju ofrohen njohuri dhe praktika të cilat do të zbatohen me fëmijët e moshës 3-6 duke e përmbyllur ciklin e plotë të planifikimit dhe organizimit të punës me fëmijët nga mosha 0-6 vjeç.

Praktika e cila do të organizohet në kuadër të kësaj lënde, e cila do të mbahet në IP do të ndihmojë studentët të observojnë dhe refletojnë atë që kanë mësuar gjatë zhvillimit të kursit mbi edukimin në fëmijëri të hershme me theks të veçantë për grup-moshat e fëmijëve nga 3-6 vjeç. Në fund të këtij kursi studentët do të kenë një pasqyrë të qartë se si duhet të punojnë me fëmijët e moshës 0-3 vjeç, 3-5 vjeç dhe grup-moshës 5-6 vjeç e cila sipas sistemit të edukimit në Kosovë i përkasin nivelit parafillor

### **GJUHË SHQIPE II**

Në këtë kurs studentet do të marrin njohuri të reja, duke i zgjeruar njohuritë e tyre paraprahe, përkritazi me: foljen dhe kategoritë gramatikore të saj, pjesët e pandryshueshme të ligjëratë (ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma). Po ashtu ata do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e organizimit të tekstit: objekti i studimit të sintaksës, klasifikimi i togfjalëshave, klasifikimi dhe llojet e fjalive, gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët plotësuese të fjalisë, klasifikimi dhe llojet e fjalisë së përbërë.

### **ARTI FIGURATIV PËR FËMIJËRINË E HERSHME**

Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë themelore si: njohja e ngjyrave bazë bisedë përgatitore për formën dhe përmbajtjen. Me zhvillimin e kësaj kursi studentët do të aftësohen për zhvillimin e aftësive tek fëmijët nga faza paranatale e deri të përfundimi i fëmijërisë

### **EDUKIM FIZIK PËR FËMIJËRINË E HERSHME**

Lënda ofron informacione në lidhje me edukimin fizik përfshirë edhe atë lëvizor në fëmijërinë e hershme që nga lindja deri në moshën 6 vjeçare. Edukimi fizik është mjaft i rëndësishme dhe duhet parë ngushtësisht i lidhur me të gjitha fushat e tjera të edukative dhe zhvillimore. Lënda ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e edukimit fizik, shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.

### **SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE**

Kursi realizohet në formë të punëtorisë dhe synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuri lidhur me konceptet dhe modelet kryesore të komunikimit dhe punës me fëmijët, dhe të kuptuarit e llojeve të ndryshme të komunikimit të fëmijëve. Kursi shtjllon më tutje njohuritë e fituara paraprakisht në kurset e tjera, për t'i aftësuar studentët ti zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët. Kursi shtjllon teorinë dhe hulumtimet më të reja për format e komunikimit dhe ndikimet ndërpersonale në komunikimi duke vënë vazhdimisht theksin tek komunikimi me fëmijë dhe përvetësimi i shkathtësive të nevojshme në edukim. Kursi është i dizajnuar të zhvillojë shkathtësitë e studentëve për të komunikuar dhe ndërvepruar me fëmijë, për të nxitur bashkëpunimin dhe për zgjidhje të konflikteve, të zhvillojë aftësitë intrapersonale dhe interpersonal të studentëve, të zhvillojë aftësitë e empatisë dhe të dëgjuarit aktiv dhe të zhvillojë të menduarit kritik të studentëve.

### **TË NXËNIT PËRMES LOJËS**

Ky kurs do të ofrojë njohuri për rëndësinë e të nxënës që fëmijët e arrijnë përmes lojës. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë teori të ndryshme për të nxënës përmes lojës, do të kenë mundësi të ushtrojnë shkathtësitë dhe kreativitetin e tyre, duke planifikuar dhe organizuar lojëra me karakter edukativ, të cilat do të bazohen në fushat zhvillimore të parapara me Kurrikulën Bërtham për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-5 vjeç dhe Kurrikulën Bërtham 1 për Klasën Përgatitore. Përmes këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të reflektojnë dhe analizojnë rolin e edukatores në përcaktimin, planifikimin dhe orientimin e fëmijëve gjatë procesit të lojës. Do të diskutohen po ashtu veçoritë e lojës në raport me moshën e fëmijës dhe specifikat që ka ajo për secilën grup-moshë (nga 0-6 vjeç). Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet dhe rolit të edukatores për të vëzhguar fëmijët gjatë procesit të lojës, përmes së cilësdo të kenë mundësi të identifikojnë interesat dhe nevojat e fëmijëve në baza individuale.

### **USHQYESHMËRIA PËR FËMIJËRINË E HERSHME**

Ushqyeshmëria dhe kujdesi shëndetësor i fëmijëve 0-3 vjet përqëndrohet në perspektivat e teorive dhe hulumtimet shkencore për të shpjeguar ndikimin e ushqimit dhe kujdesit shëndetësor në zhvillimin normal fizik dhe mental të fëmijëve të kësaj moshe. Në veçanti, kjo lëndë përmbledh çështjet të cilat studentët duhet të dinë në lidhje me rritjen, zhvillimin

dhe shëndetin psikofizik të fëmijëve të moshës më të hershme si dhe praktikat e mira të ushqyerjes

### **KULTURË SHKRIMI**

Ky kurs u mundëson studentëve t'i thellojnë njohuritë për rregullat, normat dhe parimet e drejtshkrimit të shqipes standarde, si dhe zbatimit të tyre në praktikë. Po ashtu, kursi ofron mundësi të shqyrtimit të problemeve kryesore, që dalin si sprovë e jetësimit praktik të normës së shqipes standarde, duke përfshirë edhe faktorët sociolinguistikë/jashtëgjuhësorë që e përcaktojnë shkallën e njohjes dhe të aplikimit të saj.

### **PSIKOLOGJIA E ZHVILLIMIT PËR FËMIJËRINË E HERSHME**

Kursi adreson zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës në fëmijëri të hershme dhe proceset e vazhdueshme të funksionimit psikologjik të fëmijës. Kursi shtjellon nocionet e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të njohur/kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin fizik, motorik, mendor, emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si fëmija i shfaq emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet fëmija, si mëson fëmija, dhe si të kujdesemi për fëmijën duke ruajtur mirëqenien psikologjike të tij. Studentët mësojnë për teoritë dhe studimet sistematike të zhvillimit të fëmijës, fazat e zhvillimit nga mosha paranatale deri në përfundim të fëmijërisë, karakteristikat e vecanta të secilës fazë dhe rreziqet që shoqërohen me atë fazë.

### **KONCEPTET MATEMATIKORE NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Në këtë kurs përvetësohen konceptet themelore matematikore si: logjika matematikore, bashkësitë, relacionet binare, lidhjet në matematikë, zhvillimi i konceptit numër dhe numërim, veprimet themelore në matematikë, algjebren dhe pasqyrimin, përpunimin e të dhënave, konceptin e probabilitetit (gjasës) përmes lojës dhe aktiviteteve praktike dhe shfrytëzimi i mjeteve të konkretizimit dhe atyre manipulative. Studentët do të analizojnë metodat më përshtatshme të të nxënimit të matematikës në nivelin e fëmijërisë së hershme dhe posaçërisht në klasën përgatitore.

### **MUZIKA NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Kursi ofron njohuri dhe shkathtësi themelore muzikore të cilat realizohen në mënyrë teorike dhe praktike. Kursi fokusohet në aftësimin e studentëve për të njohur/kuptuar më mire konceptet bazike, ligjshmëritë dhe informacionet për mjetet shprehëse muzikore, format dhe llojet të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikës. Kursi synon të përgatitë studentët që të njohjin dhe praktikojnë mjetet shprehëse muzikore (notat muzikore, emërtimi, vlera, lartësia, ritmi etj.) të cilat pastaj duke u gërshetuar me kurset vijuese, studentëve u hapin rrugën për interpretim të pavarur (vokal dhe instrumental) dhe aplikimin e metodave dhe strategjive në mësimdhënien e edukimit muzikor.

### **GJITHËPËRFSHIRJA NË FËMIJËRI TË HERSHME**

- Njohuritë mbi nocionet dhe bazat e gjithëpërfshirjes në fëmijëri të hershme;
- Planifikimi dhe realizimi i Planit Individual të Arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;

•Zhvillimi i klimës gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese në institucionet e arsimit parashkollor.

### **LOJËRAT SKENIKE**

Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike të përgatiten për njohjet me rëndësinë e bashkëpunimit të studentit dhe fëmijëve në fëmijëri të hershme si dhe për zbatimin e kësaj njohurie në praktikë. Studentët do të kenë mundësinë që të njohin dhe aplikojnë forma të ndryshme të lojërave dramatike dhe atyre lojërave skenike

### **IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMET E HERSHME**

Kursi përgadit studentët për implikimet e teorive dhe praktikave të zhvillimit të fëmijëve në interventimet e hershme, me qëllim për t'i aftësuar studentët t'i zbatojnë njohuritë në ndërveprimin që kanë me fëmijët. Prezentohen dhe integrohen veshtirësitë specifike në zhvillim kognitiv, gjuhësor, perceptiv, motorik, personal dhe social të fëmijëve nga periudha e posalindurit deri në fëmijëri, si dhe faktorët e rrezikur dhe faktorët mbrojtës. Studentët shkathtësohen të përdorin egzaminimin e lëvizjesë/lojës/vizatimeve si dëshmi për identifikimin e zhvillimit tipik apo atipik. Studentët mësojnë për modelet e vlerësimit të zhvillimit që përdoren në fëmijëri të hershme, modelet e intervenimit dhe metodat dhe strategjitë e punës që zbatohen në ambientet e natyrshme të fëmijës. Eksplorohehen casjet sistematike dhe familjare, dhe trajtohen raste studimore në cdo orë mësimi. Studentët shkathtësohen të identifikojnë vështirësitë/pengesat në zhvillim, të identifikojnë origjinën e tyre dhe faktorët ndikues, dhe të dizajnojnë/zbatojnë aktivitete bazike intervenuese me fëmijët.

### **PARTNERITETI ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN**

Ky kurs synon që studentët të kenë mundësi të kuptojnë më shumë mbi rëndësinë që ka partneriteti me familjen dhe njëkohësisht partneriteti me komunitetin për zhvillimit e fëmijës në të gjitha aspektet.

Institucionet parashkollore duhet t'iu krijojnë ambient të përshtatshëm fëmijëve për zhvillim, që nënkupton mirërritjen, kujdesin dhe edukimin, por njëkohësisht në lidhje me këto qëshetje, duhet të krijohet parteniteti i sukseshëm në nivel bashkëpunimi me prindërit e fëmijëve.

Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësi të njihen me format, strategjitë bashkëpunimit me mes Institucioneve parashkollore me familjen dhe komunitetin, dhe kompetencave profesionale në këtë fushë që një edukatore duhet të ketë për të filluar punën me fëmijë.

### **ZHVILLIMI GJUHËSOR**

Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që t'i njohin proceset dhe ligjësitë e veçanta të zhvillimit gjuhësor, me përqendrim të veçantë në fëmijërinë e hershme, përkatësisht në moshën parashkollore. Kursi e përkufizon zhvillimin gjuhësor duke u nisur mbi parametrat praktikë të kësaj moshe.

### **INTERPRETIMI I TEKSTIT LETRAR**

Kursi *Interpretim i tekstit letrar* përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike me qëllim që të nxirret struktura e teksteve letrare që krijohen dhe perceptohen nga grupmoshat e fëmijëve parashkollor përfshirë edhe

grupmoshat e hershme. Ky kurs përmban shumë faktorë dhe mënyra të shprehjes letrare në një tekst, që na detyrojnë të bëjmë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së tij, zbulimit të natyrës së fjalëve, interpretimit të tyre, kapjes së synimit të autorit, vokacionit, ritmit të prozës, vargut, strofës. Në programin Edukimi në fëmijëri të hershme lindje deri 6 vjeç, si tekste bazë janë librat me ilustrime me përmbajtje kryesisht nga krijimtaria popullore dhe e shkruar për fëmijë nacionale dhe botërore, paraqitur përmes librave me ilustrime duke i'u përshtatur moshës së fëmijëve. Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të kuptojnë rëndësinë e leximit për fëmijët që në fëmijëri të hershme dhe të motivohen për aplikimin e tij në të ardhmën.

### **KONCEPTET GJEOMETRIKE NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Në këtë kurs do të shqyrtohen teoritë për zhvillimin e të menduarit për hapësirën dhe kuptimet gjeometrike në fëmijërinë e hershme. Gjatë kursit, studentët do të përvetësojnë konceptet themelore gjeometrike, siç janë: Figurat gjeometrike, madhësië dhe raportet e tyre, pozitat në hapësirë, lëvizjet dhe orjentimin, dhe do të aftësohen për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përshtatshme me fëmijët 0-6 vjeç dhe në veçanti në klasën përgatitore.

### **GJUHË ANGLEZE**

Gjuhë angleze është kurs semestral i cili i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, të cilat kanë të bëjnë me tema të ndryshme nga përditshmëria nëpërmjet të cilave studentët do të jenë në gjendje të shprehin shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i përmirësojnë katër shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, në funksion të rrjedhshmërisë dhe saktësisë. Temat e mbuluara gjatë kursit do të përfshijnë një llojlojshmëri të ushtrimeve gramatikore dhe të leksikut të cilat do t'u ndihmojnë studentëve të arrijnë një zotërim të kënaqshëm të gjuhës angleze, duke pasur gjithmonë në fokus gërshetimin e kompetencës dhe performansës gjuhësore, si imperativ për zotërimin e një gjuhe të huaj.

### **INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE**

Kursi fokusohet në aftësimin e studentëve për të njohur/kuptuar karakteristikat e instrumenteve muzikore dhe mënyrën e interpretimit në instrumente me tastierë dhe instrumentet fëmijërore (sidomos ato nga grupi i instrumenteve të Orffit). Përmes këtij kursi studentët do të aftësohen të interpretojnë këngë të ndryshme me specifika për grupmoshën parashkollore. Këngët do t'i demonstrojnë në mënyrë praktike duke aplikuar teknika funksionale të interpretimit.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II (LINDJE -3 VJEÇ) (5 JAVË)**

Përmes praktikës pedagogjike studentet do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve të zhvilluara. Përmes *Doracakut të Mësimit Praktik* studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës edukative. Praktika pedagogjike organizohet fillimisht në fakultet përmes fondit të paraparë të orëve dhe pas përgatitjeve të nevojshme studentët dërgohen në institucione parashkollore. Fokusi do të jetë tek zhvillimi i aftësive të vrojtimit dhe të shkathëtsive të reflektimit. Gjatë "*Praktikës pedagogjike II*" studentët dërgohen në grupet edukative në grupmoshta nga 0-3 vjeç, kjo për arsye që studentët gjatë studimeve të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet

edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në kopsht për 4 javë rresht duke asistuar eduaktoren në të gjitha aktivitete përgatitore dhe të punës së drejtë përdrejtë me fëmijë. Në anën tjetër, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin porfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktike.

### **SHKATHTËSITË E INTEGRUARA GJUHËSORE**

Në përputhje të plotë me trendet bashkëkohore të gjuhësisë së zbatuar, qasja e integruar ndaj gjuhës do të jetë e veçanta e këtij kursi. Kategoritë gramatikore të gjuhës nuk do të shihen të ndara nga funksionet e tyre sintaksore, por ato do të analizohen si tërësi: pra edhe si trajtë gramatikore, edhe si funksion gjuhësor/sintaksor. Studentët do të aftësohen të kalojnë lehtë nga njohuritë teorike në zbatimin/aplikimin praktik të tyre.

### **QASJET E EDUKIMIT ME FËMIJËN NË QENDËR**

Kjo lëndë synon të pajisë studentët e programit të edukimit në fëmijërinë e hershme me njohuri dhe shkathtësi mbi qasjet bashkëkohore që e vendosin fëmijën në qendër të procesit edukativo-arsimor. Përmes trajtimit të parimeve, teorive dhe praktikave të ndryshme, përfshirë qasjet si Waldorf, Froebel, Hap pah Hapi dhe modele të tjera të edukimit alternativ, studentët njihen me mënyra të ndryshme të mbështetjes së zhvillimit të fëmijëve. Lënda thekson respektimin e individualitetit, interesave dhe ritmit të zhvillimit të secilit fëmijë, si dhe rëndësinë e lojës, kreativitetit dhe mjedisit nxitës për të nxënëti aktiv. Nëpërmjet reflektimit kritik dhe lidhjes së teorisë me praktikën, studentët aftësohen të planifikojnë dhe zbatojnë aktivitete që promovojnë zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve.

### **HISTORI KOMBËTARE PËR FËMIJË**

Kursi synon të përgatisë edukatorët, të cilët do të jenë në gjendje të tregojnë kuptimin e ngjarjeve historike që kanë mësuar, duke bërë lidhjet dhe duke tërhequr kontraste ndërmjet periudhave të ndryshme dhe zonave të studiuara, duke përdorur njohuritë e tyre historike për të analizuar të kaluarën dhe për të shpjeguar se si mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Edukatorët, gjithashtu, mësojnë se si, lloje të ndryshme të burimeve historike dhe letrare përdoren për të bërë spjegimin për të kaluarën. Ky kurs realizohet përmes integrimet të lëndëve të tjera, siç janë: Arti, Letërsia për Fëmijë dhe Gjeografia. Kursi është dizajnuar në mënyrë që të frymëzojë dhe të rrisë kuriozitetin e fëmijëve për të ditur më shumë për të kaluarën historike të popullit tonë.

### **ZHVILLIMI PSIKO-MOTORIK**

Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë njohuri mbi proceset dhe mekanizmat e zhvillimit të aftësive motorike: ndryshimet, proceset dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin motorik. Kursi ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe lëvizor në fëmijërinë e hershme, që janë ngushtësisht të lidhura me të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Kursi ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit fizik dhe atij motorik, ndërlidhjen e zhvillimit fizik-motor me funksionimin mendor, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe dizajnojnë aktivitete, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë. Qëllimi i kursit është të pajisën studentët me njohuri, shkathtësi dhe kompetenca për të promovuar zhvillimin motorik të fëmijët.

### **SHKENCAT E NATYRËS NË FËMIJËRI TË HERSHME**

Ky kurs është i dizajnuar për të ndihmuar studentët e programit parashkollor në zhvillimin e kompetencave dhe perspektivave të nevojshme për të qenë edukatorë të suksesshëm të fëmijëve të vegjël parashkollor. Shkenca e natyrës në fëmijërinë e hershme është një kurs që përveç përmbajtjes shkencore do të adresoj parimet dhe praktikën në mësimdhënien e shkencës së natyrës tek fëmijët. Eksplorimi dhe ekzaminimi i përmbajtjes dhe koncepteve të planprogramit të shkencave në fëmijërinë e hershme është pjesë thelbësore e këtij kursi. Edukatorët gjatë këtij kursi do të mësojnë për, dhe praktikojnë, metoda metodologjike, materiale për stimulim, eksplorim, zbulim dhe mësimdhënies të shkencës së natyrës. Përveç njohurive, edukatorët do të zhvillojnë shkathtësi dhe qëndrime të caktuara në mënyrë që ata të mund t'i udhëzojnë fëmijët drejt materialeve më të gjera, shkencore dhe kreative.

### **PSIKOLOGJIA E EDUKIMIT**

Psikologjia e Edukimit është e konceptuar si vazhdim i përmbajtjeve të mësuara në lëndën e Hyrjes në Psikologji. Kursi ofron njohuri për të nxënë dhe punën psiko-edukative me fëmijët. Kursi do të trajtojë çështje mbi edukimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshën shkollore, zbatimin e psikologjisë në studimin të nxënës, punës direkte me fëmijët, motivimit dhe çështjeve tjera, që ndërlidhen me procesin e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike në punën direkte me fëmijët, dhe i mundëson studentëve të ndërtojnë dhe rindërtojnë teoritë personale të të mësuarit përgjatë këtij kursi. Theks i veçantë do të vendoset tek të nxënës, motivimi, kreativiteti në klasë, dhe ndikimet që ka mjedisi tek sjellja e fëmijës.

### **ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I KURRIKULËS**

Kursi fokusohet në marrëdhëniet mes të teorive të zhvillimit, filozofisë, praktikës dhe zhvillimit të kurrikulës bazuar në nevojat dhe interesat e fëmijëve duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e talentuar. Do të analizohen spektri i gjerë i kurrikulave për edukimin e hershëm të fëmijëve, përfshirë edhe Kornizën Kurrikulare të Kosovës, përkatësisht Kurrikulën Bërtham për edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç dhe Kurrikulën Bërtham 1 pjesë e së cilës është edhe klasa përgatitore. Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me rëndësinë e Kurrikulës në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve në punën e tyre të përditshme. Do të kenë mundësi që të analizojnë dhe zërthejnë në praktikë Kurrikulën Bërtham për edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç dhe Kurrikulën Bërtham 1 për klasën përgatitore. Përmes së cilës studentët do të përfitojnë njohuri teorike dhe praktike për planifikimin e aktiviteteve bazuar në kompetenca, ReN, duke bërë integrimin ndërfaqor në aktivitetet e tyre. Kursi do të trajtojë edhe format e vlerësimit të kompetencave sipas shkallës.

### **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III (3 -6 VJEÇ) (6 JAVË)**

Përmes praktikës pedagogjike studentët do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve të zhvilluara. Përmes *Doracakut të Mësimi Praktik* studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës pedagogjike . Praktika pedagogjike organizohet fillimisht në fakultet përmes fondit të paraparë të orëve dhe pas përgatitjeve të nevojshme studentët dërgohen në institucione parashkollore dhe klasë

përgaditore në kuadër të shkollave fillore. Gjatë “Praktikës pedagogjike III” studentët dërgohen në grupet edukative në grupmoshta nga 3-6 vjeç, kjo për arsye që studentët gjatë studimeve të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në kopsht për 4 javë rresht duke asistuar edukatoren në të gjitha aktivitetet përgatitore dhe të punës së drejtë përdrejtë me fëmijë. Në anën tjetër, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin porfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktike.

### **PSIKOLOGJIA E PERSONALITETIT**

Kursi ofron njohuri të përgjithshme mbi zhvillimin e personalitetit të edukatorit dhe të fëmijës. Kursi shtjellon në detaje teoritë e ndryshme për zhvillimin e personalitetit, studet në teoritë zhvillimore, hulumtimet kryesore në fushën e personalitetit dhe ndikimet kryesore në zhvillimin e personalitetit; tiparet themelore të personalitetit, temperamentit dhe karakterit, vlerat, besimet dhe ndikimet e trashëgimisë dhe edukimit, si dhe përmbledh shkurtimisht çrregullimet më të shpeshta të personalitetit dhe ndikimin që këto çrregullime kanë në fëmijën, familjen dhe shoqërinë në përgjithësi. Theks i veçantë i kushtohet zhvillimit të shkathtësive të edukatoreve për gjurmim dhe njohje të vetes, reflektim personal mbi personalitetin e tyre dhe të fëmijëve, dhe të kuptuar se si ndikon personaliteti i edukatorit të fëmija dhe anasjelltas.

### **LETËRSI POPULLORE**

Kursi mëton t’u mundësojë studentëve studimin e shfaqjes, e zhvillimit, e organizimit të stileve të jetesës dhe të zakoneve, të kulturës materiale dhe shpirtërore përkitazi me format e ndryshme kulturore të krijuara nga populli ose për popullin dhe që kanë veti të popullit, me elementet e kulturës shoqërore, me studimin e familjes, me studimin e formave të ndryshme të organizimit të shoqërisë, me studimin e rregullave zakonore të komuniteteve shoqërore në përgjithësi, e në veçanti me ato të popullit shqiptar. Njohjen me historinë folkloristike gjithëbotërore dhe shqiptare duke i drejtuar në analizën e strukturave artistike dhe të vlerave të folklorit letrar sipas gjinive dhe zhanreve. T’u japë njohuri bazë rreth trashëgimisë historike në fushë të artit letrar gojor. Njohjen e mirë me gjurmët e pasura të jetës shpirtërore të popullit shqiptar, duke u dhënë njohuri të nevojshme nga letërsia popullore si formë e veçantë e krijimtarisë imagjinatave letrare.

### **KREATIVITETI NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Kreativiteti në fëmijërinë e hershme gjatë kursit do të fokusohet në çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e procesit të punës kreative me fëmijët 0-6 vjeç. Fillimisht jepet një pasqyrë rreth teorive të ndryshme që paraqesin bindje dhe qëndrime rreth sigurimit të eksperiencave kreative në fushat e ndryshme të artit e të punës me këtë kategori të fëmijëve.

### **MBROJTJA DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE**

Kursi është multi-disciplinar dhe ngritet mbi rëndësinë e aftësisë të studentëve për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, në mënyrë që këto njohuri të zbatohen në punën me fëmijët që janë nën kujdesin e tyre. Identifikimi i hershëm dhe intervenimi mbrojnë fëmijët nga situatat e rrezikshme të cilave mund të ekspozohen si rezultat i keqtrajtimit. Kursi fillimisht shtjellon instrumentet ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Më

tejt, kursi aftëson studentët për të identifikuar shenjat dhe simptomat e katër llojeve të ndryshme të keqtrajtimit apo ekspozimit ndaj dhunës dhe keqtrajtimit, efektet që kanë këto në zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës, metodat e punës me fëmijët që nuk kanë fatin të kenë një fëmijëri të lumtur, si dhe i përgatit ata për ballafaqimin me situata të keqtrajtimit në punën e tyre direkte me fëmijët. Kursi përgatit studentët për të punuar me fëmijët që vijnë nga kontekstet e ndryshme sociale dhe jetësore- fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët-prindërit e të cilëve janë në konflikt me ligjin, fëmijët – prindërit e të cilëve janë abuzues substancash psiko-aktive, fëmijët pa kujdes prindëror, etj.

### **LOJËRAT MATEMATIKORE PËR FËMIJËRINË E HERSHME**

Në këtë kurs studentët do të pajisen me dijen bazike lidhur me mënyrat se si e mësojnë më lehtë fëmijët matematikën në pajtim me moshën e tyre. Në këtë kurs ata do të përgatiten që dijen e fituar në kursin Konceptet Matematikore në Fëmijërinë e Hershme ta aplikojnë për t'i angazhuar fëmijët në institucionet parashkollore që t'i kuptojnë konceptet themelore matematikore dhe ta zhvillojnë të menduarit e tyre matematik përmes lojës dhe aktiviteteve në ambientet ku ata jetojnë. Ky kurs, i cili shpjegohet përmes lojës dhe aktivitetit, do t'i pajis studentët me këto praktikë bashkëkohore të zhvillimit të koncepteve themelore matematikore: Të menduarit matematik të fëmijëve, llojet e problemeve të cilat për bazë kanë numrat, pozitën dhe simetrinë e objekteve, formën, hapësirën, matjet dhe gjeometrinë, përpunimin e të dhënave dhe konceptin e probabilitetit (gjasës). Strategjitë e zgjidhjeve të problemeve përmes lojës dhe aktiviteteve praktike, zhvillimi i praktikave në institucionet parashkollore duke parashtruar probleme dhe duke i nxitur fëmijët që përmes tyre ta zhvillojnë të menduarit matematikor, angazhimi i fëmijëve për të mësuar nga idetë e të tjerëve, parimet matematikore dhe mbajtja aktive e të mësuarit të fëmijëve për konceptet matematikore përmes objekteve të cilat i rrethojnë që në fëmijërinë e hershme, janë pjesë e pandarë e këtij kursi.

### **SHOQËRIA DHE MJEDISI**

Ky kurs është i dizajnuar për të mbështetur studentët në programin EFH për të zhvilluar një qasje praktike, efektive të rolit të edukimit në shoqërinë njerëzore. Fillimisht studentët do të kuptojnë për rëndësinë e edukimit në kontekstin historik në shoqëri dhe teoritë kryesore mbi sjelljen njerëzore. Në kursin shoqëria dhe mjedisi përmes organizimit të punës, të mbështetur në rregullat dhe procedurat e caktuara në klasë është më se e nevojshme për të përmbushur qëllimet edukative, arsimore e sociale. Menaxhimi efektiv në klasë-grup, mund të përdoret për të krijuar klimë socio-emocionale, pozitive në klasë, çka nënkupton njehërit dhe për të minimizuar sjelljen e padëshiruar njerëzore, e veçanrisht në mjedisin ku punojnë e veprojnë fëmijët. Për të arritur këtë realizohet mësimi kooperues, respektimi i stileve të të nxënit, organizimi në bazë të afiniteteve të fëmijëve vlerësimi i drejt dhe transparent , si dhe shumë strategji të komunikimit të cilat ndihmojnë në edukimin dhe socializimin e tyre. Kursi ka për qëllim të ndihmojë studentët në ngritjen e kompetencave shkathtësive dhe aftësive të tyre për edukim të qëndrueshëm për mirëqenie, vlera demokratike dhe mjedis.

### **VLERËSIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Kursi ka për qëllim që të njoftoj studentët me teorinë dhe praktikën e vlerësimit të fëmijëve prej lindjes deri në moshën gjashtë vjeçare. Studentët do të mësojnë përse vëzhgimi, vlerësimi dhe dokumentimi janë elemente qenësore të praktikave reflektive. Ata do të

studijojnë dhe analizojnë instrumente të ndryshme të vlerësimit të cilat përdoren për të dokumentuar zhvillimin dhe përvojat e të nxëniet të fëmijëve. Vëzhgimet e fëmijëve duke përdorur këto instrumente do të zhvillojnë tek studentët shkathtësi të nevojshme për të vlerësuar nevojat e secilit fëmijë duke pasur parasysh ndryshimet individuale dhe kulturore. Ky kurs ndihmon studentët që të jenë në gjendje që përmes vlerësimit të planifikojnë dhe përkrahin nxënësit, familjen dhe komunitetin për një zhvillim të bazuar në të dhëna të drejtëpërdrejta. Studentët do të përgatiten që të jenë refketues praktik, të jenë në gjendje të konkludojnë dhe prezantojnë gjetjet e tyre përmes vlerësimit.

### **EDUKIMI SHËNDETËSOR**

Ky modul shqyrton shëndetin dhe përcaktuesit e shëndetit, aspektet rregullative vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme për shëndet, burimet dhe mundësitë për edukim shëndetësor, përgjegjësitë e edukatorëve shëndetësor në mësimin për shëndetin dhe promovimin e shëndetit. Perspektivat kulturore në shëndet dhe sëmundje. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe multidisiplinar në promovim dhe parandalim të sëmundjeve dhe planifikim të aktiviteteve. Mjediset e shëndetshme. Shkollat promovuese të shëndetit. Shkathtësitë komunikuese të aplikuar në edukimin shëndetësor. Vetitë e edukatorit të mirë. Metodot dhe mjetet edukativo shëndetësore. Ndikimi i mediave dhe materialeve audio vizuale.

### **LETËRSI PËR FËMIJË**

Programi i lëndës Letërsi për fëmijë si lëndë në nivelin universitar ka për qëllim t'i njohë studentët e programit parashkollor me letërsinë për fëmijë si fushë specifike e letërsisë në përgjithësi, si dhe me autorë e vepra që bëjnë vlerat kulminante të saj. Në këtë mënyrë studentët do të njihen me llojet letrare për fëmijë dhe do të aftësohen për punë kërkimore shkencore, duke u aftësuar për bartjen e këtyre njohurive të fëmijët, por edhe të mësimdhënësit e ardhshëm, duke aplikuar metodologji, strategji, parime, kritere, tekinke e forma të punës që lidhen me punën në institucionet parashkollore, para së gjithash, por edhe me mësimdhënien e letrësisë në shkollë.

### **METODOLOGJIA MONTESORIANE**

Ky kurs ka për synim të njoftoj studentët me filozofinë e metodologjisë Montesori duke u fokusuar tek moshën e fëmijërisë së hershme (0 deri 6 vjeç). Studentët do të aftësohen që përmes kësaj metodologjie të përkrahin zhvillimin e fëmijëve përmes praktikave sensorike. Metodologjia Montesori përgatitë studentët të zbatojnë çasjen bashkëkohore të edukimit me theks në rëndësinë e kulturës dhe pa paragjykitime. Studentët do të analizojnë ambientin, mjetet, materialet dhe sjelljet e edukatorëve që mbështesin metodologjinë Montesori. Në këtë lëndë studentët do të praktikojnë në laboratorin Montesori në Fakultetin e Edukimit teknika të punës me fëmijë duke aplikuar teorinë në praktikë. Studentët gjithashtu, do të jenë në gjendje të organizojnë ambientin dhe mjetet bazuar në standarde të metodologjisë.

### **ZHVILLIMI SOCIO-EMOCIONAL**

Kursi shtjellon nocionet e ndjenjave dhe reagimet afektive të fëmijës në periudhën e fëmijërisë së hershme, dhe reaksionet e ndërveprimet e para sociale të fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku jeton; ndikimin e këtyre të fundit në zhvillimin psiko-social të tij. Studentët do të aftësohen për të kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin emocional dhe social, atashimin dhe ndërveprimet sociale, si përvojat e hershme formësojnë zhvillimin

e identitetit social, dhe si të rriturit mund të përkrahin zhvillimin e shëndoshë socio-emocional. Studentët do të përmbledhin, analizojnë dhe reflektojnë mbi teoritë kyce të zhvillimit socio-emocionale (përfshirë teorinë e identitetit social) dhe të gjurmojnë ndërveprimet kulturore dhe kontekstuale në këtë proces

### **STEM NË FËMIJËRINË E HERSHME**

Ky kurs është dizajnuar për edukatorët në fëmijëri të hershme dhe ka për qëllim të shqyrtojë shumë aktivitete që ato duhet të realizojnë me fëmijët për të mbështetur mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve në STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë). Kursi do të shtjellojë rendësin e jashtëzakonshme të përvojës që fëmijët kanë gjatë viteve të hershme të jetës së tyre. Edukatorët do të mësojnë se fëmijët janë kureshtarë për nga natyra dhe se fëmijët duke luajtur, duke eksploruar dhe duke parashtruar shumë pyetje - mësojnë për veten, për të tjerët dhe për botën rreth tyre. Duke prezantuar STEM përmes lojës edukatorët do të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë një numër të madh të shkathtësive si p.sh. të bëjnë pyetje, të punojnë së bashku, të mendojnë në mënyrë kritike, të zgjedhin probleme, të testojnë probleme, e të zbulojnë mënyra alternative për të bërë gjerat. Me fjalë të tjera ky kurs ofron mundësin që edukatorët të zhvillojnë aftësinë e inkurajimit të fëmijëve që të bëjnë pyetje dhe të marrin një rol aktiv në të mësuarit e tyre dhe të kuptojnë botën rreth tyre.

### **EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM**

Nevoja për zhvillim të qëndrueshëm është ndër sfidat e shoqërisë njerëzore sot përfshirë shoqërinë kosovare. Kursi ofron njohuri teorike për zhvillimin e qëndrueshëm si koncept zhvillimor global dhe shkathtësi praktike për zhvillimin e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Kursi do zhvillojë kompetencat për të zbatuar strategji bashkëkohore të të nxënies për qëndrueshmëri si: qasja holistike, të menduarit sistemik dhe kritik, të nxënies me hulumtim, mësimdhënia e integruar, pjesëmarrjen në vendimmarrje si qytetar aktiv dhe të përgjegjshëm.

### **STANDARDET DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE**

Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësi të njihen me standardet të cilat duhet të plotësohen që një institucion të funksionojë më vete, me strukturën e standardeve dhe kompetencave profesionale që një edukator duhet të ketë për të filluar punën me fëmijë. Studentët do të kenë mundësi të elaborojnë në detaje secilën fushë “Instrumentit të zhvillimit profesional”. Fillimisht do të fillohet me dokumentet vendore që janë në përdorim në Institucionet parashkollore, e pastaj do të vazhdohet me ato ndërkombëtare ku studentët do të analizojnë dhe vlerësojnë mbështetur në kontekstin vendor. Po ashtu studentët do të kuptojnë rëndësinë që ka reflektimi dhe vetëvlerësimi në raport me zhvillimin profesional dhe rritjen e kompetencave profesionale përmes përdorimit të planit personal të të nxënies (PLP).

### **EDUKIMI PËRMES DRAMATIZIMIT DHE SHFAQJET ME KUKULLA**

Ky kurs synon të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuritë lidhur me konceptet kryesore të tekstit të dramatizuar përrallave apo tregimeve të cilat inskenohen në teatër. Kursi vë theksin më shumë te komunikimi me fëmijët dhe përvetësimi i shkathtësive të nevojshme në edukim. Loja e aktorit me kukullën

## **ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE PËR JETË**

Kursi ka për synim të ofroj fëmiut hapësirë të gjithëmbarshme për zhvillimin e shkathtësive të ndryshme për jetë. Kursi shkathtësitë për jetë dhe punë shtjellon zhvillimet e gjithëmbarshme të fëmiut, ndërveprimet e tij me individët tjerë, ndërveprimet më mjedisin ku ai jeton si dhe ndikimet e tilla në zhvillimin e tij. Në këtë kurs studentët njihen me mjedisin jetësor dhe me materialet e ndryshme që na rrethojnë në natyrë, përdorimin e materialeve me fëmijë për krijimin e figurave apo objekteve të ndryshme me punë individuale apo grupe si dhe nxitjen e dëshirës për punë kreative nga materialet e ndryshme nëpër qerdhe apo në institucione parashkollore. Përmes projekteve grupe dhe individuale ushtrohet zbatimi i materialeve si: letra, argjili, gipsi, sapuni, plastelina, qiri, produktet ushqimore, etj. Projektet ndijmojnë fëmijët, stimulojnë dhe rrisin nxitjen e dëshirës për punë kreative të shkathtësive të tyre për punë.

## **MJEDISI I TË NXËNIT**

Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësinë të kuptojnë më mirë rëndësinë që ka mjedisi në funksion të zhvillimit holistik të fëmijës. Mjedisit i kanë dhënë rëndësi mjaft të madhe edhe disa prej teoricienëve të mëdhenjë botëror në fushën e edukimit. Fëmijës duhet ti krijohet një mjedis i sigurt dhe stimulativ për lojë në mënyrë që fëmija të zhvillojë vetvetën, studentët do të kenë mundësi që përmes kursit të kuptojnë organizimin e mjedisëve bazuar në metodologjitë e edukimit parashkollor. Studentët do të kenë mundësi po ashtu të observojnë mjediset e të nxënit dhe të konstruktojnë lodra dhe material të ndryshme me qëllim të begatimit të mjedisit të të nxënit.

## **LOJËRAT NË NATYRË**

Ky kurs adreson rolin e mjedisit dhe aktiviteteve në natyrë me qëllim të nxitjes së kuriozitetit, kreativitetit, vëzhgimit dhe zhvillimin e mendimit kritik tek fëmijet. Kursi ka për qëllim që studentin ta pajisë me njohuri si të bëj ndërlidhjen e fenomeneve natyrore me konceptet shkencore përmes eksplorimit, lojës, ekzaminimit, vëzhgimit dhe të mësuarit. Në këtë kurs studenti do të fitoj njohuri bashkëkohore mbi natyrën dhe ndërlidhjen e njeriut me natyrën, evolucionin e natyrës dhe pozitën e njeriut në natyrë, vlerat që merr njeriu nga natyra dhe si ndikon në natyrë. Poashtu studenti do të fitoj bazë të njohurive bashkëkohore mbi komponentet përbërëse të natyrës. Duke pas parasysh edhe njohuritë e studentëve të fituara në kurset paraprake, kursi do të fokusohet poashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ndërlidhjen e mjedisit me dukuritë që ndodhin në natyrë, duke i bërë fëmijët protagonist kryesor të interaksionit ( ndërveprimit) me natyrën.

## **METODOLOGJIA REXHIO EMILIA**

Ky kurs ka për qëllim që të aftësoj studentët për punë sipas metodologjisë Rexhio Emilia, kursi avancon tutje njohuritë teorike të studentëve mbi filozofinë Rexhio Emilia dhe shkathtëson ata në përdorimin praktik të kësaj metodologjie duke ndihmuar përmes aplikimit të aktiviteteve praktike sipas kësaj metodologjie për grup moshat lindje -3 vjeç dhe 3-6 vjeç. Studentët do të analizojnë ambientin, mjetet, materialet, rolin e edukatorit, rolin e atelies dhe miniatelies, rolin e artistit, dokumentimit të punës së fëmijëve, bashkëpunimit dhe prindër dhe të tjera elementeve përbërëse të kësaj metodologjie. Studentët do të praktikohen në ndërtimin e projekteve edukative sipas qasjes rexhiane dhe të kuptuarit e filozofisë së punës me fëmijën në qendër sipas konceptit rexhian.

## **LOJËRAT MUZIKORE**

Kursi ofron metoda dhe strategji të mësimdhënies së muzikës të cilat kontribuojnë në realizimin e komponenteve të edukimit muzikor që parashihen në programin mësimor (kurrikulën e edukimit parashkollor dhe standardet e zhvillimit në fëmijërinë e hershme). Në këtë kurs studentët do të diskutojnë për aspektet teorike dhe metodat e mësimdhënies së muzikës përmes lojërave muzikore në nivelin parashkollor. Studentët gjithashtu do të realizojnë në mënyrë praktike lojërat të ndryshme muzikore (lojërat ritmike, lojëra kreative muzikore, lojërat didaktike muzikore etj.).

## **EDUKIMI PËR NDËRMARRËSI**

Në këte lëndë mundësohet përvetësimi e koncepteve bazë dhe i njohurive të avansuara në fushën e edukimit për aftësit e nxënësve në ndërmarrje, aktivitete individuale. Praktikohen aktivitete me studentë lidhur me pregaditjen e planeve individuale, familjare e grupore. Hulumtohen burime të ndryshme të informacioneve për ndërmarrje të ndryshme dhe zhvillimin e kreativitetit në ndërmarrësi. Shtjellohen ndikimi i faktorëve të ndryshëm të ndryshëm që nxizin dhe zhvillojnë vetit dhe kreativitetin e studentëve për ndërmarrësi në jetë. Punime dhe projekte të ndryshme në aftësimin e përpilimit të planeve të biznesit familjar apo edhe të planeve për ide të ndryshme tjera profitpruese. Projektidet mund të jenë nga; ndërmarrësia për ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacioneve dhe shërbime tjera, ndërmarrësi në fushat prodhuese, ndërmarrësi në fushat mjedisore. Analiza të ndryshme të studimit të tipeve të individëve (studentëve) qoftë në aspektin social, aspektin e aftësive menaxhuese dhe aspektin e vetive lidere të studentëve.

## **BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM**

Përmes kësaj lënde studentët do të kenë mundësi të përvetësojnë konceptet, përmbajtjet dhe qasjet metodologjike të hulumtimeve për fëmijët në moshë të hershme. Studentët do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike lidhur me metodat dhe teknikat e hulumtimit të çështjeve të cilat lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e fëmijëve dhe ngritjes profesionale të edukatoreve.

## **PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV (8 javë)**

Përmes praktikës pedagogjike IV studentet do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve të zhvilluara për katër vitet e studimit. Përmes *Doracakut të Mësimi Praktik* studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës pedagogjike. Praktika pedagogjike organizohet fillimisht në fakultet përmes fondit të paraparë të orëve dhe pas përgatitjeve të nevojshme studentët në varësi të prirjeve dhe nevojave që ata kanë mund të zgjedhin edhe grupin edukativ në të cilin ata kanë dëshirë apo nevojë të shkojnë.

Gjatë "*Praktikës pedagogjike IV*" studentët të pritët të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në kopsht/shkollë për 8 javë rresht duke marrur për sipër të gjitha aktivitete përgatitore dhe të punës së drejtpërdrejtë me fëmijë, nën mentorimin e edukatores mentore. Në anën tjetër, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin portfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre

në praktike. Përfundon projektin përfundimtar ashtu siç është dakorduar me profesorin.

### **PROVIMI PËRFUNDIMTAR/PUNIMI I DIPLOMËS**

Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor, bazuar në doracakun e Fakultetit të Edukimit për përgatitjen e temes së diplomës.